



KAPITULLI 6

E drejta e shoqërive tregtare

E drejta e shoqërive tregtare të BE-së përmban rregulla për krijimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare dhe menaxhimin e tyre, marrëdhëniet e tyre me aksionerët dhe palët e tjera të lidhura, përfshi punonjësit. Kjo e drejtë rregullon marrëdhënien e shoqërive që tregtohen publikisht (në bursa) me aksionerët e drejtuesit, si dhe vendos kritere për transparencën dhe veprimin në tregjet e kapitalit.

E drejta e shoqërive tregtare gjithashtu rregullon detyrimet e raportimit financiar e jo financiar (të përgjegjësisë sociale) për shoqëritë tregtare e vendos rregulla për auditin ligjor, formimin, pavarësinë dhe integritetin e audituesve.

Për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian, Shqipëria duhet të përafrojë këtë kuadër ligjor përfshi:

- rregullat për formimin, regjistrimin, bashkimin, shndërrimin dhe ndarjen e shoqërive tregtare, përfshirë operacionet ndërkufitare;
- rregullat për raportimin financiar dhe jofinanciar të shoqërive tregtare, përfshi rregullat për paraqitjen e pasqyrave vjetore dhe të konsoliduara financiare; rregullat e thjeshtuara të raportimit financiar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- rregullat për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e auditeve ligjore, të cilat duhet të garantojnë cilësinë e auditimit dhe mbikqyrjen efikase të tij.
- rregullat për zbatimin e detyrueshëm të rregullave ndërkombëtare të kontabilitetit për kompani të caktuara me interes publik.

Shqipëria duhet gjithashtu të mundësojë regjistrimin elektronik me procedurë të thjeshtuar dhe me kapital të vogël themelues të bizneseve për të nxitur kështu krijimin dhe fuqizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Këto masa do të garantojnë të drejtën për vendosje dhe zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të shtetasve dhe firmave të BE-së si dhe konkurrencën e ndershme midis tyre si në tregun shqiptar edhe në atë të të gjithë BE-së. Ato garantojnë, gjithashtu, “sigurinë juridike”—parimin që kërkon që çdo rregull i institucioneve shqiptare me efekt ligjor duhet të jetë i qartë, preciz dhe të komunikohet në mënyrën dhe kohë të përshtatshme për të lejuar përmbushjen efikase nga kompanitë.

Krahas rregullave të përgjithshme dhe atyre për menaxhimin e shoqërive tregtare dhe mbrojtjen e interesave të të tretëve, një drejtim i veçantë i përafrimit do të përqendrohet në tregjet e kapitalit. Shqipëria aktualisht nuk ka tregje të zhvilluara të kapitalit, përjashtojë tregun e shitjeve të bonove të thesarit, por ajo ka zhvilluar legjislacionin e nevojshëm në këtë fushë, i cili duhet harmonizuar me atë të BE-së.

Grupet me interes për t'u përfshirë:

Gjykatat; dhomat e tregtisë dhe të industrisë; shkollat e larta, veçanërisht Universiteti i Tiranës; shoqatat e audituesve dhe kontabilistëve të miratuar dhe shoqatat e biznesit.

Institucioni udhëheqës i negociatave:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Institucione kyçe të përfshira në negociatë:

- Ministria e Financave
- Qendra Kombëtare e Biznesit
- Bordi i Mbikëqyrjes Publike
- Banka e Shqipërisë
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit